



URDHËR

Nr. 74, Datë 21/08/2017

Për

ngritjen e grupit të monitorimit për konkurset e pranimit, në ciklin e dytë të studimeve "Master i arteve/Master Shkencor" dhe "Master Profesional" që zhvillohen në fakultetet e Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2017 - 2018

Në bazë të nenit 25 (Departamenti), neni 42 (Drejtuksi i njësisë kryesore), neni 39 (Rektori), Neni 69 (*Format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë*), Neni 70 (*Ciklet dhe programet e studimeve*), Neni 75 (*Programet e ciklit të dytë të studimeve*), Neni 76 (*Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve*), të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 18, datë 16.08.2017, të MAS, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 19.05.2017, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 - 2018" (*Kreu VI/4, Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional dhe Master i arteve/Master shkencor"*), me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së procedurave të konkurseve të pranimit, evidentimin dhe korrigjimin e mangësive që mund të shfaqen,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të monitorimit për konkurset e pranimit, **në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional dhe Master i arteve/Master shkencor"** që zhvillohen në fakultetet e Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2017- 2018, me përbërje si më poshtë:
 - a) Prof. Dr. Erald Bakalli, Zëvendës rektor;
 - b) Znj. Sonila Agaj, Përgjegjëse e Sektorit Mësimor & Informimit të Studentëve;
 - c) Znj. Edlira Isak Specialiste e Sektorit Mësimor & Informimit të Studentëve
2. Grupi i monitorimit të marë masa që: "Udhëzimit nr. 18, datë 16.08.2017, të MAS, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 19.05.2017, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 - 2018", të afishohet në hyrjen kryesore të UART, në ambiente hyrëse të fakulteteve si dhe në faqen zyrtare të UA, me qëllim informimin sa më mirë të konkurrentëve dhe publikut.
3. Dekanët e fakulteteve, Sekretarët mësimorë pranë fakulteteve, brenda datës **04 Tetor 2017**, të shpallin datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim. Këto njoftime bëhen në ambiente të dukshme pranë fakulteteve dhe në faqet e tyre të internetit;



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488. www.uart.edu.al

4. Zv/rektori për anën mësimore i UART, Sektori Mësimor & Informimit, Sektori i statistikës, Sekretaritetë mësimore pranë fakulteteve, të marrin masat e nevojshme që: aplikimet në çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë, të bëhen pranë sekretarive të fakulteteve, **deri në datën 20 tetor 2017, ora 14-⁰⁰**.
5. Pranë departamenteve të fakulteteve deri në datën **20 Tetor 2017**, të ngrihen komisionet **ad-hoc**, sipas njësisive bazë, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve, në bazë të kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i UA;
6. Dekanët e fakulteteve në UART, të marrin masat e duhura që konkurset të zhvillohen nga data **21 Tetor deri më 22 Tetor 2017**. Fakultetet brenda **datës 24 Tetor 2017** të afishojnë listat e aplikantëve fitues sipas rendit zbritës në përputhje me kuotat e miratuara për secilin program;
7. Regjistrimet e kandidatëve fitues bëhen pranë sekretarive mësimore brenda **datës 30 Tetor 2017**. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës, bashkëlidhur Udhëzimit nr. 18, datë 16.08.2017, të MAS për secilën kategori. Brenda **datës 1 Nëntor 2017** Fakulteti shpall listat e studentëve të regjistruar.
8. Dekanët e Fakulteteve brenda **datës 13.11.2017**, të dërgojnë në Rektorat, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, në adresën zvrektor.mes@uart.edu.al me qëllim pajisjen me numër matrikulli. Rektorati brenda **datës 15.11.2017** në formë shkresore dhe elektronike të përcjellë listat e kandidatëve të regjistruar për secilin program studimi në QSHA;
9. Në përfundim të konkurseve të pranimit, Grupi i Monitorimit, të hartojë, "Raportin mbi zhvillimin e konkurseve të pranimit të studentëve të ciklit të dytë "Master profesional dhe Master i arteve/Master shkencor", në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2017 - 2018;
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Zv./Rektori për anën mësimore, Dekanët e Fakulteteve, Sektorit Mësimore dhe i Statistikës pranë rektoratit, Sekretaritetë mësimore pranë fakulteteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot CAUSHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE